



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2546, datë 13.03.2015

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Plus Communication sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522 dhe 2524, datë 6.11.2014”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 13.03.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Plus Communication sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522 dhe 2524, datë 6.11.2014

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.
5. VKD nr. 2522, datë 06.11.2014 për “Miratimin Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Dokumentit Përfundimtar”;

6. VKD nr. 2524, datë 06.11.2014 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Plus Communication dhe vendosjen e masave rregulluese”;
7. VKD nr.____, datë____2015, për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Plus Communication sh.a. me nr.1149 Prot, datë 11.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2651 Prot., datë 12.12.2014) me anë të së cilës Plus ka paraqitur ankim administrativ për modifikim të pjesshëm të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2522 dhe nr.2524, datë 6.11.2014;
2. Shkresa e AKEP me Nr. 2723 Prot, datë 18.12.2014, drejtuar të katër operatorëve celularë për informacion shtesë mbi ankimet e tyre administrative;
3. Shkresa e Plus Communication sh.a. me nr.1209 Prot, datë 26.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2723/1 Prot., datë 29.12.2014)
4. Shkresa e Plus Communication sh.a. me Nr.34 Prot., datë 16.01.2015;
5. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (Relacioni);

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, ka miratuar dokumentin “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme-Dokumenti Përfundimtar”, dhe bazuar në këtë dokument janë marrë Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014, për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre dhe masat përkatëse rregulluese për statusin e FNT.
2. Të katër operatorët celularë kanë depozituar në AKEP ankime administrative, sipas shkresave të cituara më sipër, si dhe informacion shtesë bazuar në kërkesën e AKEP. Secili operator ka ankimuar Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, si dhe një apo disa nga Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014. Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014 kanë si pjesë arsyetuese dokumentin e analizës së tregut celular të miratuar më VKD nr.2522, datë 6.11.2014.
3. Plus Communication sh.a. në ankimin e depozituar me shkresën me nr.1149 Prot, datë 11.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2651 Prot., datë 12.12.2014) ka kërkuar revokimin e Vendimeve nr.2522 dhe nr.2524 datë 6.11.2014, që kanë lidhje me miratimin e dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimin për Fuqinë e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese për Plus Communications

sh.a. Plus nëpërmjet ankimit kërkon që AKEP të ndryshojë dokumnetin e analizës së tregut duke përcaktuar tregun me pakicë të shërbimeve në rrjetet celulare si treg të justifikueshem për nderhyrje ex-ante dhe shpalljen e operatorëve AMC, Vodafone dhe Altelecom si operator me fuqi të ndjeshme në këtë treg si dhe heqjen e detyrimit për eliminimin e diferencimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit për operatorin PLUS. Në përfundim të pretendimeve të paraqitura, Plus Communication i kërkon AKEP të marrë në konsideratë ankimin e Plus Communication Sh.A. dhe të vendosë:

1. Pranimin e ankimit administrativ të PLUS;
 2. Revokimin e pjesshëm të Vendimit të Këshillit Drejtues nr.2522, date 6.11.2014 Për "Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Dokumenti Përfundimtar", në lidhje me:
 - përcaktimin e tregut me pakicë të shërbimeve në rrjetet celulare si treg të justifikueshem për nderhyrje ex-ante dhe shpalljen e operatorëve AMC, Vodafone dhe Altelecom si operator me fuqi të ndjeshme në këtë treg;
 - heqjen e detyrimit për eliminimin e diferencimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit për operatorin PLUS.
 3. Revokimin e pjesshëm të Vendimit Nr.2524, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipermarrësit PLUS Communication Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të levizshëm PLUS Communication dhe vendosjen e masave rregulluese", dhe konkretisht pikën 4 të këtij Vendimi në lidhje me vendosjen e detyrimit për PLUS për mosdiskriminimin e thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit.
- 4.** AKEP ka trajtuar ankimin e Plus Communication, duke marrë në konsideratë edhe ankimet e tre operatorëve të tjerë celularë si palë të interesuara në vendimet e ankimuara, duke reflektuar përkatësisht në Vendimet nr.2522-2526, datë 6.11.2014. Këto ndryshime janë bërë nëpërmjet Vendimit të KD të AKEP me nr ___, datë ___.2015, vendim i cili përmban të plotë pjesën arsyetuese të ndryshimeve dhe trajtimin e ankimit të Plus Communication.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Mos-pranimin e ankimit administrativ të Plus Communication sh.a., kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522 dhe nr. 2524, datë 6.11.2014, duke bërë ndryshime në vendimet e cituara sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. ___, datë ___ 2015, për "*Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014*".

2. Të njoftohet sipërmarrësi Plus Communication sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**